



**RAPORTI I VLERËSIMIT
TË CILËSISË SË
PROGRAMEVE TË
STUDIMIT NËPËRMJET
ALUMNI-T**

SHKURT 2025



**SEKTORI I SIGURIMIT TË
BRENDSHËM TË CILËSISË
DHE AKREDITIMIT**



PUNOI:

HARIKLA BEDULI

PRANOI:

SONILA BËSHTIKA

VLORE 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE	3
Hyrje	5
Baza Ligjore:	8
Ligji i Arsimit të Lartë	8
STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR IAL, MIRATUAR ME VKM NR. 824, DATË 24.12.2021:	8
Statuti i UV-së	9
Kuadri Ligjor	10
Etika	10
Metodologjia	11
Kufizimet	11
SEKSIONI I	13
SEKSIONI II	20
SEKSIONI III	24
SEKSIONI IV	35
Gjetjet kryesore	37
Përfundime	38
Lista e shkurtesave	39
Bibliografia	39



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

PËRMBLEDHJE

Alumni ka për qëllim informimin e vazhdueshëm dhe orientimin e studentëve të UV-së në funksion të një karrierë të suksesshme. Alumni organizon të gjithë studentët që janë diplomuar ndër vite dhe ato që do të diplomohen në të ardhmen në UV, promovon studentët që kanë mbaruar studimet, nxit pjesëmarrjen e tyre në konferenca dhe aktivitete të ndryshme.

ALUMNI kujdeset që të mbajë të gjitha të dhënat e ish-studentëve, në kuadër edhe të asistencës së ofruar për ta, për t'i integruar në tregun e punës apo karrierës së tyre në fushën kërkimore dhe akademike.

Ish-studentët përfitojnë informacione të rëndësishme në workshope, ku krijojnë njohje dhe lidhin kontakte të rëndësishme.

Alumni është pjesë e strukturave të UV-së dhe shërben për koordinimin e formimit teorik dhe atij praktik të studentëve.

Për këtë qëllim ne mbajmë lidhje me sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe shërbime të karrierës të universiteteve të ndryshme.

Qëllimi ynë është për të ndihmuar studentët që të kenë përgatitjen e duhur për profesionin e tyre të ardhshëm. Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit, kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira matëse të cilësisë. SSBCA harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rezultate për secilin pyetësor të realizuar me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Ka shumë pika të rëndësishme të theksuara në këtë plan për të përmirësuar eksperiencën dhe shanset e suksesit të studentëve të UV-së.

Duke përfshirë studentët aktualë dhe të mëparshëm në një rrjet të strukturuar si ALUMNI, ne sigurojmë një pjesëmarrje të qëndrueshme në zhvillimin e tyre pas përfundimit të studimeve. Organizimi i konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme është një mënyrë e shkëlqyeshme për të ndihmuar studentët të zhvillojnë njohje dhe kontakte të rëndësishme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Kjo mund të jetë rrugë efektive për të hapur dyert drejt mundësive të punës dhe të ndërtimit të një rrjeti profesional. Po ashtu, duke ofruar mundësi për praktikë profesionale në kompani të ndryshme, ne përpiqemi t’u japim studentëve një eksperiencë praktike që i ndihmon ata të zbulojnë fushën e tyre të interesit dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës.

Ndërkohë Sektori për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit është kritike për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të siguruar që universiteti është në rrugën e duhur për të përmbushur qëllimet e tij arsimore. Kjo përfshirje e Alumni-t dhe përkushtimi për përmirësimin e cilësisë së arsimit janë thelbësore për të siguruar që studentët e UV-së të jenë të përgatitur për suksesin në karrierën e tyre të zgjedhur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Hyrje

Universiteti i "Ismail Qemali" Vlorë, si Institucion i Arsimit të Lartë themeluar që prej vitit 1994, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UV janë organizuar pyetësorë me studentët dhe ish student (në këtë rast), të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UV përmes perceptimit të studentëve ALUMNI. Pyetësori me studentët ALUMNI është një pyetësorë që realizohet 1 (një) herë në 3 (tre) vjet në koordinim me Sektorin e Karrierës dhe ALUMNI-t si dhe Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit.


Pyetësori me studentët ALUMNI është implementuar për herë të parë gjatë periudhës 15.10.2023 – 15.12.2023. Duke patur një pjesëmarrje pothuaj të papërfillshme, u ripërcoll për t'u implementuar përsëri përgjatë vitit akademik 2024 - 2025.

Ky raport përqëndrohet në pjesëmarrjen e Alumni-t në pyetësorin e dërguar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Si pjesë e përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë edukative dhe shërbimet universitare, u dërgua një pyetësor në mbi **2300** (dy mijë e treqind) alumni të diplomuar përgjatë viteve akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 si dhe 2022-2023, me qëllim që të mblidhen mendime dhe sugjerime të vlefshme. Edhe pas shumë përpjekje nga Sektori I Karrierës dhe Alumni-t për të kontaktuar me Alumnin e UV-së dhe për të shpërndarë këtë pyetësor, përfundimi nuk është I kënaqshëm.

Të dhënat e pjesëmarrjes

- Numri i dërguar: 2313 alumni të shpërndarë
- Numri i pjesëmarrësve: 64 alumni
- Shkalla e pjesëmarrjes: 2.76%

Më poshtë shihet paraqitja grafike e pyetësorëve të shpërndarë dhe të plotësuar.



Grafiku 1

Analiza e pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e alumni në pyetësor është **2.76%**, që përfaqëson një numër të ulët të përgjigjeve në krahasim me numrin e përgjithshëm të dërguar. Kjo tregon disa nga sfidat që përballen institucionet në angazhimin e alumni për të kontribuar në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit.

Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga SSBCA përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë. Studentët ALUMNI janë përgjigjur përmes pyetësorit online (<https://forms.gle/nUN8HCuWnELu9uUi9>) që ka qenë i lidhur me SSBCA-në. Pyetësori është i përbërë prej 28 (njëzet e tetë) pyetje të ndara në 3 (tre) seksione dhe është i fokusuar mbi të dhënat e të anketuarve, mbi programin e studimit që kanë përfunduar, ciklin e studimit dhe kohëzgjatjen e tij, si dhe seksioni I fundit I përbërë prej 2 (dy) pyetjeve të cilat kanë për qëllim vjeljen e informacionit mbi përfshirjen e studentëve Alumni në aktivitete të ndryshme që organizon UV-ja, si dhe identifikimin e instrumentave të preferuar prej studentëve për informim nëpërmjet të gjitha platformave digjitale (si facebook, web, e-mail, sms etj).

Është shumë e rëndësishme që Universiteti i "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërmarrë këtë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar procesin e sigurimit të cilësisë nëpërmjet pyetësorëve me studentët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

ALUMNI. Kjo është një mënyrë e shkëlqyeshme për të mbledhur dhe vlerësuar mendimet e tyre, duke u fokusuar në perceptimin e tyre për gjendjen reale në UV dhe përvojën e tyre në programet e studimit. Fakti që pyetësi është bërë anonim dhe është realizuar përmes një platforme online tregon angazhimin për transparencë dhe objektivitet në mbledhjen e të dhënave. Duke e organizuar këtë proces në bashkëpunim me Sektorin e Karrierës dhe ALUMNI-t, si dhe Sektorin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit, sigurohet një përkushtim i plotë për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Seksionet e ndryshme të pyetësit, duke përfshirë të dhënat mbi programet e studimit, ciklin e studimit dhe pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet e universitetit, ofrojnë një pasqyrë të plotë të përvojës së studentëve dhe mundësojnë identifikimin e zonave për përmirësim.

Përfshirja e studentëve Alumni në aktivitete të ndryshme të organizuara nga UV-ja dhe identifikimi i preferencave të tyre për informim nëpërmjet platformave digjitale tregon një përqasje progresive drejt përshtatjes së ofrueshmeve të tyre me nevojat dhe preferencat e studentëve.

Këto përpjekje të vazhdueshme dhe të koordinuara për të matur cilësinë dhe përvojën e studentëve janë thelbësore për të siguruar që UV-ja ofron një mjedis arsimor i cili është i përshtatshëm dhe i cilësuar për studentët e saj.

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- ✓ Përgatitjet për karrierë;
- ✓ Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara;
- ✓ Plan-programi i studimeve;
- ✓ Bashkëpunimi me UV edhe pas studimeve;
- ✓ Përshtypjet për UV-në;
- ✓ Sugjerimet dhe komentet.

Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, përbën prioritet vendosja e qëndrueshme e standardeve të cilësisë në veprimtarinë mësimdhënëse me qëllim formimin e studentëve, si profesionistë të së ardhmes me mundësi konkurimi në tregun ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Njëkohësisht rezultatet dhe gjetjet e përfuara në përfundim të pyetësorit ALUMNI ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të përmbushjes së kriterëve të standardeve të Kodit të Cilësisë në IAL.

Baza Ligjore:

Vlerësimi i periodik i programeve të studimit dhe përfshirja e studentëve në këto procese sanksionohet dhe parashikohet në një sërë aktesh ligjore dhe rregullatore në nivel kombëtar dhe në nivel institucioni.

Ligji i Arsimit të Lartë

Neni 98: “Të drejtat dhe detyrimet e studentëve: Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionet e arsimit të lartë;”

Neni 103: “Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore”;

Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR IAL, MIRATUAR ME VKM NR. 824, DATË 24.12.2021:

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Kreu X, Neni 103, Pika 4 “*Njësia e Sigurimit të Cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit*”, në përmbushje të standardeve për Sigurimin e Cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë, miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, specifikisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

- **Standardi I.9, Kriteri 4:** “Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve të atyre të diplomuar, kërkues shkencor, bashkëpunëtor etj”.
- **Standardi III 10, Kriteri 2:** “Institucioni dëshmon se në procesin e monitorimit përfshihen edhe palët e treta, studentët, alumni ose ekspertë të jashtëm”.
- **Standardi III 16, Kriteri 6:** “Institucioni përdor feedback-un e alumni-t për të përditësuar kurrikulat me qëllim përshtatjen me tregun”.
- **Standardi V 9, Kriteri 1:** “Institucioni përdor forma bashkëpunimi me studentët e diplomuar në të mirë të rritjes së cilësisë në programet aktuale”.
- **Standardi V 9, Kriteri 2:** “Institucioni përfshin studentët e diplomuar në procese të rishikimit dhe riorganizimit të kurrikulave, si dhe hapjes së programeve të reja”.
- **Standardi V 9, Kriteri 3:** “Institucioni organizon anketime me student të diplomuar me qëllim matjen e vlerës së diplomave të ofruara dhe njehsimit me kualifikimet e tregut”.

Statuti i UV-së

Neni 73: “Të drejtat dhe detyrimet e studentëve: Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionet e arsimit të lartë”;

Neni 80: Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë: “ Harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare”;

Neni 82: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: “Kjo njësi ka për funksion kryesor: bashkëpunimin për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

shkencor, si dhe zhvillimit cilësor të UV-së si institucion i arsimit të lartë, mbështetur në standardet shtetësore të cilësisë, si dhe në udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.”

Kuadri Ligjor

- Vendim Senati Nr.13, datë 06.05.2021, Rekomandimi Nr. 7, objekti specifik Nr. 3: “Përmirësimi I programeve të studimit nëpërmjet Vlerësimit të ALUMNI” (organizimi I pyetësorit për ALUMNI-n);
- Urdhër Rektori Nr. 64, datë 26.07.2022 Ngritja e grupit të punës për hartimin e pyetësorit për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-t;
- Vendimit të Senatit Nr.14, datë 10.03.2023 për “Miratimin e Pyetësorit të vlerësimit të cilësisë të programeve të studimit nëpërmjet ALUMNIT”;
- Vendimit të Senatit Nr.20, datë 24.04.2023 të Senatit Akademik, "Mbi miratimin e procedurës së analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-t".

Etika

Respektimi i integritetit akademik dhe luftimi i diskriminimit dhe pabarazisë është thelbësore për një institucion arsimor të suksesshëm si Universiteti i "Ismail Qemali" Vlorë. Sigurimi që pyetësori të zhvillohet në përputhje me këto parime tregon një përkushtim të fortë për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë pjesëmarrësve.

Publikimi i raportit të rezultateve dhe rekomandimeve të përcjella nga SSBCA dhe KSBCI, duke respektuar Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe llogaridhënies së plotë ndaj pjesëmarrësve të pyetësorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Ky proces i transparencës dhe i respektimit të ligjit siguron që të dhënat dhe rezultatet e mbledhura janë të mbrojtura dhe të trajtuara me kujdes, duke u garantuar privatësia dhe integriteti i të gjithë pjesëmarrësve. Kjo përpjekje për të respektuar dhe zbatuar standardet më të larta etike dhe ligjore në organizimin e pyetësorit tregon një angazhim të plotë për të siguruar një mjedis arsimor i cili është i drejtë dhe i barabartë për të gjithë.

Metodologjia

Seksioni i parë, është i përbërë prej 9 (nëntë) pyetje dhe është i fokusuar mbi të dhënat e të anketuarve, mbi programin e studimit që kanë përfunduar, ciklin e studimit dhe kohëzgjatjen e tij. Njëkohësisht është e rëndësishme të theksohet se me qëllim vjeljen e një informacioni sa më objektiv, studentët teknikisht ia janë përgjigjur nëpërmjet pyetjeve kushtëzuese në **Google Forms**.

Në seksionin e dytë, të anketuarit japin vlerësimin e tyre mbi aspektin profesional dhe punësimin si Alumni të Universitetit tonë. Cili është vlerësimi i disa aspekteve pas përfundimit të studimeve. Ky seksion është i përbërë prej 6 (gjashtë) pyetjeve.

Seksioni i tretë, ka 11 (njëmbëdhjetë) pyetje. Në këtë seksion studentët Alumni mund të shprehin vlerësimet mbi programin e studimit që kanë ndjekur, nëse i ka përgatitur për tregun e punës, a kanë fituar aftësi e njohuri?

Seksioni i fundit, ka 2 (dy) pyetje, të cilat kanë për qëllim vjeljen e informacionit mbi përfshirjen e studentëve Alumni në aktivitete të ndryshme që organizon UV-ja, si dhe identifikimin e instrumentave të preferuar prej studentëve për informim nëpërmjet të gjitha platformave digjitale (si facebook, web, e-mail, sms etj).

Kufizimet

Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor të ndryshëm në institucionet e arsimit të lartë mbetet një prej sfidave më shpesh të hasura gjatë procesit të implementimit, veçanërisht kur mungojnë masat që kushtëzojnë plotësimin e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Megjithëse pyetësi iu dërgua studentëve ALUMNI në llogarinë personale, duke qenë se më tej ai u plotësua në formatin *Google Forms*, siguri i një informacioni më të detajuar do të mundësonte analizë më të hollësishme brenda sektorëve përkatës për të evidentuar praktikën e mirë, me qëllim jo vetëm inkurajimin por edhe përmirësimin e mëtejshëm atje ku performanca është më pak e mirë.

Për kapërcimin e kufizimeve të mësipërme sugjerohet një sërë veprimtarish:


- ♣ Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor sugjerohet ndërmarrja e fushatave informuese por njëkohësisht gjetja e mekanizmave kufizues sikurse aplikohen për pyetësin e studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Në vijim për secilin prej seksioneve të pyetësit, janë parqitur grafikisht rezultatet e pyetësit, si dhe përgjigjet e sugjerimet e studentëve ALUMNI, për të përmirësuar shërbimin respektiv. Gjatë paraqitjes së rezultateve të pyetësit është respektuar etika e përpunimit të të dhënave si dhe është ruajtur konfidencialiteti.

SEKSIONI I

Seksioni i parë fillon me një informacion të përgjithshëm mbi gjininë e alumni-t që plotësuan pyetësonin. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet përqindja ku 64.1% janë femra. Nga 64 pjesëmarrës, 41 ishin femra dhe vetëm 23 meshkuj e shprehur kjo në përqindje 35.9%. Grafiku si vijon:


1. Gjinia



Grafiku 2

2. Viti i diplomimit


Në pyetjen e periudhës së vitit të diplomimit janë përgjigjur 62 alumni. Ku përqindjen më të madhe e zë viti 2023 me 38.7%. Një përqindje të mirëfilltë zë dhe viti 2021, 11.3%. Grafiku më poshtë ilustron situatën:



Grafiku 3

3. Kohëzgjatja e studimeve


Në pyetjen e katërt reflektohet qartazi që pjesëmarrësit në pyetësor kanë përfunduar programin e studimit bachelor rreth 38.1%, 36.5% kanë përfunduar ciklin master, 17.5% kanë përfunduar ciklin 4-vjeçar, si dhe 7.9% tjetër. Grafiku si vijon:



Grafiku 4

4. Fakulteti që keni mbaruar studimet

Mbi pyetjen se cilin fakultet keni ndjekur studimet tuaja, 39.1% kanë përfunduar ciklin e studimeve pranë Fakultetit të Ekonomisë, 25% Fakultetin e Shëndetit, 21.9% Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe 14.1% Fakulteti i Shkencave Humane. Grafiku i mëposhtëm e paraqet më qartë situatën:



Grafiku 5

5. Programi i studimit

Tabela e mëposhtme jep një paraqitjetë komenteve të studentëve Alumni mbi programin e studimit që ata kanë ndjekur në UV. Janë paraqitur në mënyrë të hollësishme të gjitha përgjigjet e studentëve. Duke qenë një pyetje fakultative **64** studentë i janë përgjigjur pyetjes së hapur prej të cilëve **6.25%** kanë ndjekur programin “Infermieri e Përgjithshme” dhe po në të njëjtën përqindje “Master profesional në gjuhën angleze”. Tabela 1 si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

<i>Nr.</i>	<i>Komenti</i>	<i>%</i>
1.	Ekonomiks	3.12
2.	Infermieri e përgjithshme	6.25
3.	Infermieri Mami	4.68
4.	Financë	4.68
5.	Matematikë-Financë	1.56
6.	Master profesional Mësuesi në Gjuhën Angleze	6.25
7.	Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në lëndën Informatikë	1.56
8.	Biologji	3.12
9.	Inxhinieri mekanike	3.12
10.	Matematikë + Master Mësuesi Matematikë	1.56
11.	Ekonomiks në sipërmarrje	1.56
12.	Shkenca kompjuterike	1.56
13.	Bachelor Informatikë	1.56
14.	Histori-Gjeografi	1.56
15.	Kimi	1.56
16.	Inxhinieri elektrike	4.68
17.	Marketing + master profesional marketing	4.68
18.	Gjuhë Angleze	1.56
19.	Administrim Biznesi	4.68
20.	Drejtësi	1.56
21.	Italisht	1.56
22.	Pasuri të paluajtshme	1.56
23.	Master Shkencor në Ekonomiks	1.56
24.	Teknologji Informacioni	1.56

Tabela 1

6. *Cikli i studimit*


Pyetja e radhës i përket ciklit të studimit që Alumni ka ndjekur në UV. 28 pjesëmarrës në pyetësor rreth 4.08% kanë ndjekur programet e studimit bachelor, 54.7% programet master dhe vetëm 1.6% programin 4 vjeçar. Grafiku si vijon:



Grafiku 6

7. Nota mesatare në master


19.5% e pjesëmarrësve në pyetësor, notën mesatare të programit master që kanë ndjekur studimet e tyre pranë universitetit “Ismail Qemali” Vlorë e kanë patur 8, 17.1% e tyre me notën mesatare 7, 9.8% me notën mesatare 6. Në përqindje të barabartë janë dhe nota mesatare 8.3 dhe 9.6. Përqindjet e tjera jepen në grafikun si vijon:



Grafiku 7

8. Doktoraturë, nota mesatare

Në pyetjen mbi notën mesatare të programit të ciklit të tretë doktoraturë i janë përgjigjur vetëm 9 pjesëmarrës. Ku në përqindje të barabartë 66.6% nuk ia janë përgjigjur pyetjes përkatëse. Ndërkohë 11.1% a alumneve e kanë patur notën mesatare 6, 7 dhe 8. Grafiku si më poshtë:




Grafiku 8

9. Diplomë e integruar e nivelit të dytë, nota mesatare

Nga 64 pjesëmarrës 18 prej tyre i janë përgjigjur se kanë ndjekur studimet në programin e integruar të nivelit të dytë me notën mesatare 8 rreth 22.2%, 16.7% e kishin notën mesatare 7, 27.9% nuk janë përgjigjur, si dhe në përqindje të barabartë 5.6% notat mesatare kanë qenë 6, 6.5, 7, 7.45, 8.2, 8.7 dhe 9.98.

Grafiku 9 si më poshtë:




Grafiku 9

SEKSIONI II

Seksioni I dytë I përket aspektit profesional si dhe punësimit të studentëve alumni të UV-së. Roli I universitetit në ofrimin e mundësive dhe zhvillimin e aftësive praktike është thelbësor për suksesin dhe arritjen e alumni-t.

10. Pas përfundimit të studimeve në fakultet, ku jeni punësuar


64 studentë Alumni të UV-së janë përgjigjur se 34.4% janë punësuar në sektorin privat pas përfundimeve të studimeve, 28.1% janë ende të papunë, 12.5% janë të punësuar në sektorin publik, 6.3% janë shprehur se janë punësuar jashtë shtetit por jo në profilin e tyre si dhe e njëjta përqindje janë të punësuar jashtë dhe në profilin e tyre. 4.7% kanë hapur biznesin e tyre si dhe e njëjta përqindje janë të punësuar në sektorin privat por në fushë tjetër, 1.6% e të anketuarve janë të punësuar në biznesin familjar. Grafiku si vijon:



Grafiku 10

11. A jeni punësuar në profesionin tuaj?


Në seksionin e dytë të anketuarit pyeten rreth punësimit të tyre. 46.9% janë të punësuar, 42.2% nuk janë të punësuar dhe 10.9% të përafërt. Grafiku 11 si vijon:



Grafiku 11

12. Pas përfundimit të studimeve në fakultet a gjetët punë menjëherë?


Alumni kësaj pyetje I është përgjigjur me **po** ose **jo**, ku 56.3% mbizotëron përgjigjja **jo** dhe 43.8% janë shprehur **po**. Grafiku si më poshtë:



Grafiku 12

13. Studimet në universitet më kanë ndihmuar në aspektin profesional


Shumë prej studentëve Alumni janë shprehur se studimet në UV I kanë ndihmuar në aspektin profesional shumë rreth 48.4% e të anketuarve, 18.8% janë ndihmuar pak nga studimet në UV, në përqindje të barabartë 14.1% janë shprehur shumë fare dhe neutral në përgjigjet e tyre. 4.7% studimet në UV nuk I kanë ndihmuar në aspektin profesional. Grafiku si vijon:



Grafiku 13

14. Studimet në universitet profesionalisht më kanë përgatitur vetëm në aspektin:


Studimet në UV shumë studentë I kanë ndihmuar në aspektin profesional, por ata janë shprehur se këto studime kanë qenë të vlefshme si në aspektin teorik dhe praktik me 53.1% të të anketuarve. 40.6% janë shprehur se UV-ja I ka ndihmuar në aspektin teorik, si dhe vetëm 6.3% nuk kanë qenë të kënaqur me studimet dhe janë shprehur se nuk kanë pas asnjë aspekt që të ndihen të përgatitur. Grafiku I mëposhtëm:



Grafiku 14

15. Cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm nga 1-10 (ku vlerat më të larta tregojnë nivel më të lartë dakordësie) për programin e studimit që keni ndjekur?

Studentët Alumni janë pyetur dhe mbi vlerësimin e tyre për programin e studimit që kanë ndjekur në UV. 31.3% janë shprehur me 8, e cila tregon një nivel të kënaqshëm të dakordësisë. 23.4% e kanë vlerësuar me 10 nivelin e dakordësisë, 17.2% e kanë vlerësuar me 9, 9.4% janë shprehur me 7, në përqindje të barabartë 6.3% e kanë vlerësuar programin e studimit përkatësisht me 6 dhe 5, si dhe në të njëjtën përqindje dakordësie 1.6% e kanë vlerësuar përkatësisht me 8.5, 7.5, 3.... Grafiku si vijon:




Grafiku 15

SEKSIONI III

Për nga rëndësia ky seksion ka të bëjë mbi programet studimore në UV, përshtatshmërinë me tregun e punës, zhvillimin e aftësive profesionale, etj. Më poshtë jepen më të detajuara pyetjet dhe grafikët përkatës.

16. Mendoni se programi studimor i ofruar nga fakulteti, ju ka përgatitur për tregun e punës?

Alumni janë një komponent i rëndësishëm për çdo universitet, duke përfshirë Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Angazhimi dhe mbështetja e alumne-ve është kriter kyç për rritjen dhe zhvillimin e UV-së. 59.4% janë shprehur dakord dhe se programi studimor që ata kanë ndjekur i ka përgatit disi për tregun e punës, 15.6% ishin plotësisht dakord, 17.2% ishin neutral, as dakord dhe as jo dakord, si dhe 7.8% nuk ishin dakord. Për informacionin të mëtejshëm grafiku më poshtë:




Grafiku 16

17. Programi studimor që kam përfunduar është i përshtatshëm për zhvillimin tim profesional

Alumni-t krijojnë një rrjet të fuqishëm profesional që mund të jetë shumë i dobishëm për studentët aktualë dhe ata të ardhshëm, duke ofruar mundësi për praktikë, punësim dhe mentorim. Grafiku 17 I mëposhtëm tregon qartazi se 56.3% e alumne-ve kanë shprehur dakordësinë se programi studimor që


kanë përfunduar është I përshtatshëm me zhvillimin e tyre profesional, 26.6% ishin plotësisht dakord, 12.5% as dakord e as jo dakord, si dhe vetëm 4.7% nuk ishin dakord.



Grafiku 17

18. Studimet universitare më mësuam si të fitoja aftësi dhe njohuri të reja në mënyrë të pavarur


Studimet universitare për 62.5% të pjesëmarrësve në pyetësin e Alumni-t janë shprehur se kanë fituar njohuri të reja dhe në mënyrë të pavarur. 25% ishin plotësisht dakord, 7.8% janë shprehur neutralisht dhe vetëm 4.7% s'janë dakord. Grafiku 18:



Grafiku 18

19. *Plani mësimor i programit të studimit më ka ofruar mundësi zgjedhjeje të lendëve që tani më duhen drejtpërdrejtë në punë.*


Grafiku 19 paraqet një pamje me 37.5% e Alunneve kanë qenë dakord me planin mësimor të programit të studimit të ofruar, 15.6% plotësisht dakord, 20.3% neutral, 23.4% nuk ishin dakord dhe vetëm 3.1% nuk ishin aspak dakord që plani mësimor që kishin studiuar lidhej drejtpërdrejtë me punën që kishin zgjedhur.



Grafiku 19

20. *Studimet universitare më përgatitën të mendoj në mënyrë analitike dhe logjike*


Studimet universitare jo vetëm që ndihmojnë në ndërtimin e njohurive të reja, por gjithashtu zhvillojnë aftësi të rëndësishme analitike dhe logjike që janë të nevojshme për suksesin profesional të gjithë secilit. Grafiku 20 paraqet 57.8% të alumni-t ishin dakord se këto studime i kishin përgatitur, 25% plotësisht dakord, 14.1% neutral dhe vetëm 3.1% nuk ishin dakord. Në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Grafiku 20

21. Mbahem i informuar për zhvillimin e vazhdueshëm në universitet, si shpalljet për vendet e lira të punës, konferenca, seminare, trajnime


Alumni I UV-së nga 37.5% e pjesëmarrësve në pyetësor kanë shprehur dëshirën që do dëshironin të ishin të informuar mbi çdo konferencë, trajnime, etj. 15.6% ishin plotësisht dakord, 21.9% neutral, 20.3% nuk ishin dakord dhe 4.7% nuk ishin aspak dakord. Grafiku 21 si më poshtë:



Grafiku 21

22. Unë u rekomandoj të tjerëve që të studiojnë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë


Për të rinjtë që janë në kërkim të një universiteti për të studiuar, alumni I UV-së është shprehur me plotësisht dakord se do t'a rekomandonte në masën 42.2%, 37.5% ishin dakord, 17.2% ishin neutral dhe në përqindje të barabartë 1.6% nuk ishin dakord dhe aspak dakord. Grafiku si vijon:



Grafiku 22

23. Cilat janë përshtypjet tuaja për Universitetin "Ismail Qemali" si Institucion i Arsimit të Lartë?

Alumni të suksesshëm kontribuojnë në ndërtimin e reputacionit të universitetit, duke treguar se cilësia e arsimit dhe programet e ofruara janë të besueshme dhe efektive. Ndaj tek ky pyetësor jemi përpjekur të njihemi me përshtypjet e studentëve alumni për të vjel informacion dhe mendime të vlefshme për përmirësimin e kurseve dhe programeve, përmes përvojave të tyre në tregun e punës. 51.6% janë shprehur të kënaqur, 25% shumë të kënaqur, 12.5% neutral, 4.7% të pakënaqur dhe 6.3% shumë të pakënaqur. Grafiku si vijon:



Grafiku 23

24. Cilat konsideroni 3 pika të forta dhe 3 pika të dobëta të programit të studimit në të cilin ju keni studiuar?

Duke pasur Alumni të njohur në fusha të ndryshme, universiteti mund të përfitojë nga promovimi i atyre, gjë që ndihmon në tërheqjen e studentëve të rinj. Një lidhje e fortë me alumni-n ndihmon në ndërtimin e një komuniteti më të përfshirë dhe aktiv, që kontribuon në zhvillimin social dhe ekonomik të rajonit. *Tabela 2* e mëposhtme tregon qartë se UV-ja ka pika të cilat duhet të rregullohen për zhvillimin e mëtejshme dhe për studentët e rinj. Pikat e forta të UV-së sipas alumni-t më shpesh e cituar janë pedagogë të përgatitur, mundësia në tregun e punës nga fushat e larmishmëri e programeve të studimit, mësimdhënia dhe mirëkuptimi, e shumë të tjera.

Por krahas pikave të forta. Ish studentët e UV-së kanë shprehur dhe pikat e dobëta, ku më të cituarat janë: mungesa e praktikës dhe orë laboratorike, mungesë literature e mirëfilltë, etj. *Tabela 2* si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

NR.	3 PIKA TË FORTA	3 PIKA TË DOBËTA
1.	1) Ndjekja e leksioneve dhe seminareve ne prezence fizike brenda periudhes post-covid (tetor 2021). 2) Konsultimet me pedagoget per paqartesite e lendeve te zhvilluara ne mesimin online gjate pandemise se Covid-19. 3) Keshillimet per anen profesionale ne lidhje me profesionin e rregulluar qe fitohet nga programi i ciklit te dyte te studimit.	1) Ndjekja e leksioneve dhe seminareve online gjate pandemise se Covid-19. 2) Berja e provimeve online dhe me pas mungesa e studenteve per arsyje objektive ne provimet online 3) Mungesa e informacioneve ne lidhje me kurset e zhvilluara ne programin e studimit te siperpermendur.
2.	Praktika, leksionet seminaret	Nje nga deget me te mira te universitetit por qe askush nuk me punesoj ndaj ishte nje humbje kohe. Stafi petagogjik Praktika në mësimdhënie
3.	Komunikimi, mirekuptimi, pergatitja teorike	Nevoje per me teper praktika dhe ore laborator
4.	1. Përgatitja shkencore e profesorëve 2. Gjendshmëria për të na suportuar 3. Programe koherente	Pikat e dobeta jan sepse nuk ka laborator te mirfillti dhe nuk te meson mbi programet kopjuterike qe perdoren ne pune.
5.	Mundesit te mira punesimi,profesion human,socializing	Të dobëta nuk kam
6.	Petagog te pergatitur Leksione te permbledhura Mundesit studimi per te gjithë nivelet e studenteve	Kushte jo aq te favorshme punesimi jo vleresim i duhur i infermiereve
7.	1-Literature e pasur 2-Leksione dhe seminare te rregullta 3-Pedagoge te pergatitur	Jo praktikat te realizuara sic duhet Tu kushtohet me teper rendesi ideve /ndryshimeve te sugjeruara nga studentet
8.	Marredheniet me jashte jane pike me e forte e unversitetit I përshtatshëm me tregun e punës	1-Veshtiresi ne gjetjen e tregut te punes pas perfundimit te studimeve 2-Nevoja e eksperiences ne cdo vend ku aplikohet per pune 3-Mungesa e perkrahjes nga institucionet per studentet qe duan te futen ne pune pasi mbarojne studimet
9.	1.Teoria 2.Kualiteti mesimit 3.Vlersimi	Më tepër praktike në biznese apo institucione
10.	Pik e fort qe petagoget qe shpejgojn	1.Munges e Praktikes 2.Programi i Lendeve te zhvilluara ne shkolle ne perballje me cfar kerkon tregu i punes 3.Me shum lend Teknike per tu zhvilluar dhe per te dal na bankat e shkolles ne koherence me cfar kerkon tregu i punes
11.	Me e pergatitur , e zhvilluar profesionalisht, dhe me e formuar	Kam ber gabim qe kam studiuar ne at deg
12.	1-Racional 2- Qendrimi kritik 3-Njohuri te pergjthshme mbi shkencën e ekonomise	Vendi kur zhvillohet mesimi edhe duhet te behet me shum pratik
13.	Ke mundesi zhvillimi, Staf i pregatitur, komunikim i mire.	1-Praktika e pamjaftueshme 2-Orientimi mbi tregun e punës 3-Marrja e riskut ne biznes
14.	Cilesia e mire e petagogeve dhe mirekuptimi me ta,	Duhet te fokusohet me shume ne praktike,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

		te njohe me tregun e punes, te jape info baze te profesionit
15.	Kam mundesi ne tregun e punes ne shum fusha Aftesia për të filluar një punë, pavarësia,	Munges stafi dhe laboratoresh dhe nje programi te mirfillte per praktik
16.	Kerkohet nga tregu i punes Njihet jashte Shqiperise	Ka shume teori Nuk ka motivim nga stafi pedagogjik Nuk ka internship Ste ofron kompj ne dispozicion gjate leksionit
17.	1. Profesorë/et 2. Cilësia e mësimdhënies 3. Bashkëpunimi me universitetet e huaja	1- Shumë pak lënd praktiken 2- Limiti minimal i mesatares përpara pranimit (duhet të jet më I lartë) 3- Nuk ka implementuar ende diplomën e dyfishtë (pra me një degë madhore dhe një minore)
18.	Tregu punes, mundesia per zhvillim ne kohe te gjate	Paaftesia per pregatitje profesionale mungese e njohurive ne aspektin praktike
19.	Nuk kam asnje koment jam shume e kenaqur me programin	Mungesa e kurseve Mungesa e praktikave ne shkoll Sjellja jo e pershtatshme e lektoreve me Studentet.
20.	Korrektesia disiplina vlersimi	Përgatitja për një industri në rritje Ndërveprimi i teorisë dhe praktikës Diversiteti i mundësive të karrierës
21.	Shpjegimi, interpretimi, praktika	Mbështetje e kufizuar për të kuptuar kontekste lokale Konkurrenca e lartë për pozitat në industrinë e turizmit Varësia nga faktori ekonomik dhe sezonalitet
22.	Profesionalazmi dedikimi i petagogeve	Lendet me zgjedhje, seminaret, tualetet
23.	• mesim i rregullt •angazhim ne praktika •staf profesional	mungojn praktikat ne terren ku studenti ta njohi profesionin me nga afer sesa nga librat
24.	-Pedagog te pergatitur -Kushtet e mesimdhënies	1. Mungojn libra; 2. Mendoj se shume pedagoge (jo te gjithë) nuk jan te afte per ate pune; 3. Universiteti nuk jep asnje lloj mundesie trajnimi nga ana praktike dhe si pasoje asnje lloj mundesie punesimi.
25.	Konsistenca, liria e zgjedhjes, prakticiteti	Intensiteti, mungesa e praktikave punesimit
26.	1. Pergatitje teorike e mire 2. Orare te rregullta 3. Cilesi	1. Munges praktike ne laborator 2. Mungesa e lendeve me zgjedhje te lire 3. Studentet ekslent nuk u vleresuan me certifikata dhe asgje tjeter dhe nuk ju jepet mundesia e punesimit ne universitet
27.	Mirekuptim, miresjellje, bashkepunim.	Studimi
28.	Shpjegimi	Nuk ka vende pune ne Vlore ne lidhje me kete dege


	rendesia aftesia	
29.	Vazhdoni si jeni se shume mir jeni Perkushtimi Aftesia Mesimdhenia Korrektesia	Pedagoge qe nuk kane informacion as per vete dhe qe priren drejt servilizmit dhe parase. Sigurisht edhe pedagoge te formuar, por te rralle. Shumica i debuan edhe ata pak studente qe ishin. Programi shume i mire ne teori por praktike zero.

Tabela 2

25. Ju lutem renditni komponentët e mëposhtëm të përvojës suaj në departamentin në të cilin keni studiuar sipas rëndësisë/dobisë

Sikurse mund të evidentohet edhe prej grafikut 24, në bazë të rezultateve në këtë pyetje megjithëse pjesëmarrja në pyetësor është e ulët, në përgjigje të tyre ata shprehën se komponentët e mëposhtëm:

- Kurset e nevojshme
- Lëndët me zgjedhje
- Seminare
- Praktikë/përvojë në terren
- Aktivitete (folës, programe, etj.)



Grafiku 24


Tek *Tabela 3* janë të dhënat e komponentëve me përqindje, të vlerësuara nga 1 tek 5. Shihet qartë se dimensionimi më i keq i vlerësuar është lëndët me zgjedhje me 4, rreth 7.81%, ndërsa dimensionimi më i vlerësuar me 1 rreth 35.93% është kurset e nevojshme.

	<u>1</u>	<u>2</u>	<u>3</u>	<u>4</u>	<u>5</u>
<i>Kurset e nevojshme</i>	35.93%	21.87%	25%	9.37%	14.06%
<i>Lëndët me zgjedhje</i>	26.56%	31.25%	26.56%	7.81%	12.5%
<i>Seminare</i>	20.31%	26.56%	25%	21.87%	14.06%
<i>Praktikë/përvojë në terren</i>	25%	25%	21.87%	14.06%	18.75%
<i>Aktivitete (folës, programe, etj)</i>	21.87%	23.43%	32.81%	10.93%	14.06%

Tabela 3

26. *Nqs do ndryshonit një gjë të vetme nga programi i studimit që ju keni ndjekur, cila do të ishte ajo?*

Në pyetjen e fundit të seksionit të tretë Alumni i UV-së është shprehur se nuk do të ndryshonin asgjë nga programi i studimit me rreth 15.6%, mbi 60% e të anketuarve do të dëshironin të kishin më shumë praktikë, si në sektorin privat ashtu dhe në sektorin publik. Grafiku si më poshtë:




Grafiku 25

SEKSIONI IV

Seksioni I katërt është I përbërë vetëm nga 2 (dy) pyetje, të cilat kanë të bëjnë mbi kontributin e Alumnit mbi zhvillimin e mëtejshëm të UV-së. Nëpërmjet angazhimit në aktivitete dhe projekte të universitetit, alumni mund ndihmojë në krijimin e një rrjeti mbështetës që promovon rritjen akademike dhe profesionale. Kontributi i alumni në promovimin e reputacionit të universitetit në tregun e punës siguron që institucioni të mbetet i lidhur me nevojat e industrisë dhe zhvillimin e politikave edukative të qëndrueshme.

27. A keni dëshirë të kontribuoni në zhvillimin e universitetit të Vlorës?


Pyetjes nëse studentët Alumni të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, të cilët kanë studiuar në një prej cikleve të studimit (Cikli I Parë, I Dytë, por dhe I Tretë), do të kishin dëshirë të kontribuonin në zhvillimin e të ardhmes së UV-së, janë shprehur me 48.4% me **po**, 40.6% janë shprehur me nuk e di dhe 10.9% me **jo**. Grafiku më poshtë:



Grafiku 26

28. Nqs ju do të jeni i/e ftuar të jepni një leksion si i ftuar/një fjalim special apo të ndani eksperiencën uaj për studentët e rinj në UV, a do të pranoni?

37.5% janë shprehur se do të dëshironin të ishin pjesë e një leksioni ku të ndanin eksperiencën e tyre pranë UV-së, 42.2% janë shprehur se nuk e dine nëse do ta ndanin këtë eksperiencë, ndërkohë që 20.3% janë shprehur jo. Grafiku si vijon:



Grafiku 27



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Gjetjet kryesore

Pyetësi është plotësuar nga studentët ALUMNI, përmes linkut të vendosur në dispozicion nga SSBCA dhe shpërndarë përmes sektorit të Karrierës Akademike dhe Alumni-t, nëpërmjet platformave të ndryshme të komunikimit me ta.

Nga të gjeturat, studentët Alumni kanë qenë të sinqertë në përgjigjet e tyre dhe komentet e sygjërimit e bëra, tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset e mëtejshme në UV. Ky raport shpreh vetëm statistikën e përgjithshme që dalin nga tërësia e përgjigjeve të marra.

Studentët ALUMNI kanë vlerësuar se studimet që kanë ndjekur, i kanë përgatitur mirë për karrierën e tyre duke ju ofruar mundësi për të fituar aftësi dhe njohuri të reja në mënyrë të pavarur.

Studentët ALUMNI kanë vlerësuar se shkathtësitë dhe njohuritë e fituara janë në gjendje t'i aplikojnë në punët e tyre që janë angazhuar. Pjesë për t'u trajtuar është pjesa e lëndëve zgjedhore e cila duhet të shikohet nga njësitë akademike për t'ju ofruar lëndë zgjedhore më të nevojshme për punë.

UV-ja përmes Sektorit të Karrierës dhe ALUMNI i mban të informuar për shpalljet për konferenca, ngjarje, seminare, trajnime, si dhe ligjëratat publike me qëllim të avancimit profesional, por që në këtë pjesë duhet të punohet edhe më shumë.

Ajo u mundëson studentëve të mbajnë lidhjet mes tyre me qëllim të bashkëpunimit edhe pas përfundimit të studimeve.

Në përgjithësi të gjithë të anketuarit ALUMNI janë të kënaqur me UV dhe programet që kanë ndjekur dhe rekomandojnë të tjerët të ndjekin studimet këtu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Përfundime

Në përfundim, raporti i pyetësorit për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-t, për vitin akademik 2023-2024 i ripërcjellë përgjatë vitit akademik 2024-2025 dhe i strukturuar sipas çështjeve dhe fushave të kërkuara, synon të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së UV-së në zbatim të misionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Pas shqyrtimit të përgjigjeve të Alumni-t në UV dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, duke parë që kishte një pjesëmarrje aktuale të ulët prej **2.76%**, është e qartë se duhet zbatuar një qasje më e angazhuar për të inkurajuar alumni-n të kontribuojnë në proceset e vlerësimit të programit. Këto të dhëna do të ndihmojnë në rafinimin e strategjive për të rritur angazhimin dhe për të siguruar që opinioni i alumni-t të llogaritet në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programeve por dhe të universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Lista e shkurtesave

- **VSA** - Vendim Senati Akademik
- **UV**- Universiteti i Vlorës
- **SSBCA** – Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit
- **ALUMNI** - është një ish-student i diplomuar në një institucion arsimor
- **KSBCI** – Komisioni I sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional

Bibliografia

<https://univlora.edu.al/statuti/> (Neni 80, Fq. 46)

<https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Senati-Nr.-13-date-06.05.2021-Per-Miratimin-e-Planit-te-Veprimit-ne-Kuader-te-Rekomandimeve-te-Lena-nga-Bordi-Akreditimit.pdf>

<https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-Senati-Nr.-14-date-10.03.2023-Per-miratimin-e-pyetesorit-te-vleresimit-te-cilesise-se-programeve-te-studimit-nepermjet-alumnit.pdf>

<https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Vendim-Senati-Nr.-20-date-24.04.2023-Per-miratimin-e-procedures-te-analizes-dhe-vleresimit-te-pyetesorit-te-vleresimit-te-cilesise-te-prog.-te-studimit-nepermjet-alumnit.pdf>